

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
LUSHNJE**

VENDIM
Nr 36 date 30.05.07

Mbi miratimin e projektit te Festivalit Folklorik Tipologjik Kombetar I Valles Popullore "Lushnje- Qershor 2007-Programi Dytesor".

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 30.05.2007 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kultures mbi miratimin e projektit kulturor-artistik "Festivali Folklorik Tipologjik Kombetar I Valles Popullore –Lushnje-Qershor 2007-Programi Dytesor" bazuar ne V.K.M Nr. 309 date 21/06/1993 "Mbi shperblimin e cilesise artistike " – dhe me V.K.M Nr.441 date 15/08/1994 pika 10,3 "Mbi detyrat e Seksionit te Kultures " si dhe duke u mbeshtetur ne Ligjin Nr. 8652 date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" – Kreu IV neni 10, pika II germa a:

VENDOSI :

Te miratoje projektin kulturor – artistik te paraqitur nga Drejtoria e Kultures :

1. – "Festivali Folklorik Tipologjik Kombetar I Valles Popullore –Lushnje – Qershor - 2007"- Programi Dytesor- me vlere prej 1.000.000 leke Shuma do te levrohet nga buxheti i Bashkise nepermjet fondit te percaktuar per Projektet Kulturore –Artistike te Drejtorise se Kultures.
2. – Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kultures dhe Drejtoria e Finances – Bashkia Lushnje.

**KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK
VASILIKA HOXHA**

